

THIRRJE PËR APLIKIM

Autoriteti i Mediave Audiovizive në mbështetje të nenit 50, pika 3 e ligjit nr. 97/2013 “Për Mediat Audiovizive në Republikën e Shqipërisë” kërkon të rekrutojë një ekspertit të jashtëm të kualifikuar në fushën e komunikimit për asistencë në hartimin e Strategjisë së Komunikimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

TERMAT E REFERENCËS

Objektivi dhe qëllimi

Objektivi kryesor i kësaj strategjie do të jetë përmirësimi i imazhit institucional të autoritetit të mediave audiovizive nëpërmjet një qasje më të ngrohtë dhe fryme bashkëpunimi me palët e treta dhe publikun në tërësi. Me këtë strategji duhet të synohen vlerat themelore të komunikimit, shpërndarja e informacionit, pjesëmarrja efikase e publikut, mediave dhe shoqërisë civile si dhe të garantohet platforma e komunikimit të debateve publike. Trendet e komunikimit formal e joformal, të brendshëm e të jashtëm, ndërpersonal e publik, të komunikimit të drejtëpërdrejtë e të tërthortë, vertikal e horizontal duhet të jenë parime udhëzuese të kësaj strategjie që ju dedikohet të gjithë atyre që në çfarëdo mënyre janë të ndërlidhur me sektorin e mediave audiovizive.

Detyrat

Eksperti nëpërmjet dokumentit që do të dorëzojë duhet të:

1. Të përcaktojë një vijë strategjike komunikimi të institucionit;
2. Të ngrejë në tërësi profilin e AMA-s, nëpërmjet propozimit të aktiviteteve të ndryshme;
3. Të përmirësojë marrëdhëniet e institucionit me palët e treta, nëpërmjet propozimit të aktiviteteve të ndryshme;
4. Të përmirësojë komunikimin e jashtëm dhe çështjeve publike;
5. Nëpërmjet strategjisë së komunikimit duhet të bëhen të qarta fuqitë ligjore të rregullatorit;
6. Nëpërmjet strategjisë së komunikimit duhet të thellohen njohuritë e palëve të interesit me rolin e AMA-s;
7. Strategjia duhet të përmbajë objektiva të qarta dhe të përcjellë mesazhe kyçe
8. Dokumenti final duhet të jetë i shoqëruar me një plan veprimi: Cfarë/kush/kur/sa

Kriteret për përzgjedhjen e ekspertit të jashtëm në fushën e komunikimit

1. Të zotërojë diplomën e shkollës së lartë në shkenca shoqërore. Kualifikimet në fushën e komunikimit do të përbëjnë avantazh;
2. Të ketë minimalisht 5 vite eksperiencë në fushën e komunikimit;
3. Të ketë minimalisht 1 vit eksperiencë në fushën e komunikimit në institucion publik;
4. Të ketë minimalisht 1 vit eksperiencë në fushën e komunikimit në institucion publik;
5. CV e nënshkruar, shoqëruar me kopje ID/Pasaportë;

Kandidatët duhet të dorëzojnë dokumentacionin e kërkuar brenda afatit pranë Drejtorisë së Burimeve Njerëzore dhe Marrëdhënieve me Jashtë, të Autoritetit të Mediave Audiovizive.

Adresa: Rruga “Papa Gjon Pali II”, Tiranë

APLIKIMET MBYLLEN MË DATË 11 DHJETOR, 2017